



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

NJOFTIM

**Shtyrje e afatit për dorëzimin e dokumentacionit shtesë – Skema Kombëtare e Mbështetjes
2026**

Të nderuar fermerë aplikantë,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural njofton të gjithë fermerët aplikantë në kuadër të Masave Kombëtare të Mbështetjes nr. 1–7 dhe nr. 9 se, është shtyrë afati për dorëzimin e dokumentacionit shtesë.

Afati i ri përfundimtar për dorëzimin e dokumentacionit shtesë është 11 shtator 2026. Shtyrja e afatit synon t'u krijojë aplikantëve mundësi të mjaftueshme për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar, si dhe të lehtësojë procesin e administrimit dhe verifikimit.

AZHBR u bën thirrje të gjithë aplikantëve që ende nuk kanë përfunduar plotësimin e dokumentacionit, të dorëzojnë dokumentet përkatëse brenda afatit të ri të përcaktuar.

Për informacion të mëtejshëm, aplikantët mund t'u drejtohen Agropikave ose të konsultojnë kanalet zyrtare të komunikimit të AZHBR-së.